



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM**

6635

M. S. 16

URDHËR

Nr. 60, datë M. S 2016

“PËR

**FILLIMIN E PROCESIT TË CERTIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM
NË SEKTORIN PUBLIK PËR SEZONIN 2016-2017”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pikës 1 të nenit 19 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe “Rregullores për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.37, datë 16.03.2016,

URDHËROJ:

- 1) Fillimin e procesit të certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, në sezonin 2016-2017, dhe hapjen e procedurës së aplikimeve të kandidatëve për auditues të brendshëm dhe trajner në këtë proces.
- 2) Të drejtën për të aplikuar, si kandidat për auditues të brendshëm, e kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, si më poshtë:
 - a) Të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet;
 - b) Të kenë përvojë pune 3 vjet në profesion;
 - c) Të jenë të punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik.
- 3) Kandidatët që aplikojnë për auditues të brendshëm, duhet të paraqesin zyrtarisht në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesë me shkrim;
 - b) Curriculum Vitae;
 - c) Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë të noterizuar;
 - d) Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
 - e) Vërtetim punësimi ku specifikohet dhe pozicioni i punës në njësinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
 - f) Certifikatën e gjendjes gjyqësore.
- 4) Të drejtën për të aplikuar për trajner e kanë personat që plotësojnë kriteret si më poshtë:
 - a) Trajnerët e kategorisë së parë duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:
 - i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 6-10 vite përvojë pune në fushën përkatëse;

- ii. Diplomë postmaster apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - b) Trajnerët e kategorisë së dytë, duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:
 - i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe mbi 10 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - ii. Gradë apo titull shkencor dhe minimalisht 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
 - c) Njohuri të mira të standardeve profesionale të auditimit të brendshëm dhe të kenë përvojë praktike në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
 - d) Aftësi për të hartuar një program mësimor në lidhje me temat e moduleve dhe ta prezantojë atë në një mënyrë sa më të qartë përpara auditorit.
 - e) Aftësi për të shpjeguar në një mënyrë të thjeshtë përmbajtjen e programit të certifikimit;
 - f) Aftësi për t’ju përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të bëra nga pjesëmarrësit, duke përdorur shembuj praktikë;
 - g) Aftësi për të zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore;
 - h) Të kenë përkushtimin e duhur për të këshilluar kandidatët për auditues të brendshëm gjatë gjithë procesit të certifikimit;
 - i) Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi.
- 5) Kandidatët për trajner, duhet të paraqesin zyrtarisht në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) Kërkesë me shkrim;
 - b) Curriculum Vitae;
 - c) Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në auditimin e brendshëm;
 - d) Fotokopje të noterizuar të diplomave;
 - e) Rekomandime ose certifikata që vërtetojnë eksperiencën profesionale, aftësitë pedagogjike, si dhe integritet moral dhe reputacion të mirë;
 - f) Certifikatën e gjendjes gjyqësore.
- 6) Pranimi i dokumentacionit për kandidatët që aplikojnë për auditues dhe për trajner do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
- 7) Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

